

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. .....<sup>325</sup>.....Rep.

Nr. ....Koll. ....

## KONTRATE SHITJE

Ne Tirane sot me daten 27 Shkurt 2004 (dymijeeqater), para meje noterit Gaqo Shesh, me zyre ne Rruga " Zhan D' Ark", pall.6, prane Gjykates se Shkalles se Pare, u paraqiten personalisht para meje palet:

**SHITESI:** PET RIT GANOLLI, i biri i Shefqetit, banues ne Lushnje, me cilesine e ortakut te "LUNDRA" Sh.P.K. madhor, me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me pasaporten personale Nr. 3287395.

**BLERESJA:** KRISTO GANOLLI, i biri Shefqetit, lindur e banuese ne Lushnje, identifikuar me leternjoftimin personal NF Nr.005729, madhor, me zotesi te plote per te vepruar.

Te cilet kerkuan redaktimin e kontrates se shitjes si me poshte:

**Shitesi Petrit GANOLLI** eshte ortak i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "LUNDRA" Sh.p.k., regjistruar person juridik me vendimin Nr.27313 date 05.03.2002 te Gjykates se Rrethit Tirane. Ai me vullnetin e tij te lire e te plote i shet z. Kristo GANOLLI kuotat e tij te prej 50 % = 50.000 leke te kapitalit themeltar te shoqerise, shitje kjo e realizuar jashte kesaj zyre.

**Bleresi z. Kristo GANOLLI** deklaroi se eshte dakort dhe ka blere nga shitesi Petrit GANOLLI kuotat e tij prej 50% te kapitalit themeltar te shoqerise "LUNDRA" Sh.p.k. = 50.000 leke dhe i ka likujduar atij shumen perkatese jashte kesaj zyre.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate z. Petrit GANOLLI humbet ortakerine ne shoqerine "GANOLLI" Sh.P.K. Ndersa z. Kristo GANOLLI behet ortak i vetemdhe adminiustrator i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "LUNDRA" Sh.p.k. duke zoteruar gjithe kapitalin themeltar te shoqerise.

Kjo kontrate u redaktua ne tre kopje dhe pasi u lexua u gjend sipas vullnetit te paleve, te cilet e nenshkruajne ate para meje, ndersa une noteri e vertetoj dhe e regjistroj sipas ligjit.

SHITESI

Petrit GANOLLI



BLERESI

Kristo GANOLLI



NOTER

Gaqo SHESHI

